



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:111858
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05571255

PA1.nr.419/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm - në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti, kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Mehmet Ndrecaj-anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarit R. H. , nga P., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i besimit, nga neni 330 par.1, të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar XXXXX- av. Sh. F. , të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, P.nr.135/2023, datë 19.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 03.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar XXXXX-av. Sh. F. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren Dega në Suharekë, P.nr.135/2023, datë 19.12.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, me aktgjykimin, P.nr.135/2023, datë 19.12.2023, të akuzuarin R. H. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i besimit, nga neni 330 par.1, të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me kusht, duke ia caktuar dënimin me burgim prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në kohën e verifikimit prej një 1 (një) viti i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënim me gjobë, në lartësi prej 200 (njëqind) € e cila gjobë duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata dënimin me gjobë do të ia zëvendësoj në dënim me burgim, prej 10 (dhjetë) ditësh, ashtu që 1 (një) ditë burgim llogaritet me 20 (njëzet) € gjobë. Është obliguar i akuzuari me shpenzimet e procedurës, ashtu që në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 (njëzet) €, dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 (njëzet) €, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim

të përmbartimit të detyruar. E dëmtuara, udhëzohet që kërkesën pasurore - juridike ta realizoj në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur:

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar XXXXX- av. Sh. F. , për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën të aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptohet dënim më i rëndë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.425/2024, të datës 18.03.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit të i shqiptohet dënim më i ashpër.

Gjykata e Apelit e Kosovës, mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e atakuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar është e palejuar.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore për të cilat është ushtruar ankesa, sipas detyrës zyrtare Gjykata e Apelit konstaton se ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar në rastin konkret është e palejuar. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, vepra penale për të cilën është gjykuar i akuzuari, hynë në kategorinë e veprave penale ku nuk lejohet ankesa e të dëmtuarit, për asnjë bazë ankimore. Sipas dispozitës së nenit 381 par.3 të KPPK-së parashihet se: *“I dëmtuari mund të ushtrojë ankesë ndaj aktgjyimit vetëm për shkak të vendimit të gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale për trafikim me qenie njerëzore, dhunën në familje, veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për kërkesën pasurore juridike kur i akuzuari shpallet fajtor shpenzimet e procedurës penale që ndërlidhen me te ”.*

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se ankesa e të dëmtuarës, konform nenit 400 të KPPK-së është e palejuar, ngase pala e dëmtuar, në rastin konkret për veprën penale Keqpërdorim i besimit, nga neni 330 par.1, të KPRK-së, nuk lejohet e drejta e ankesës.

Andaj, duke u bazuar në këto që cekën më lart, e në pajtim me nenit 400 të KPP-së, ankesa e të dëmtuarit është hedhur si e palejuar.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti i Përgjithshëm

PA1.nr.419/24, datë 03.04.2024

Zyrtarja ligjore
Rrezarta Bala

Kryetari i kolegjit
Abdullah Ahmeti